

POSTA SHQIPTARE SH.A
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 04.07.2018

PËR: OPERATORIN EKONOMIK “SINTEZA CO” SHPK NIPT K11324003F

Adresa: Rruga Fortuzi Nr.5 , Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. 21, datë 27.04.2018 për kryerjen e prokurimit publik me objekt: “Blerje pajisje IT (printer termik, kompjuter, printer, aparat VOIP....etj)”, me fond limit 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa t.v.sh. me procedurë te hapur në elektronike, mbështetur në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Procedurë e cila u zhvillua më datë 23.05.2018, ora 10:00, [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF -65795-04-27-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje IT (printer termik, kompjuter, printer, aparat VOIP....etj)”

Fondi Limit: 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa t.v.sh.

Kohëzgjatja e kontratës: Afati i dorëzimit dhe montimit të mallit është 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës;

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X
oferta ekonomikisht më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.05.2018, ora 10:00;

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 07.05.2018 [18]*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik C.C.S sh.p.k me NIPT J61901033C me oferte ekonomike 34.854.700 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind) leke pa TVSH.
2. Operatori Infosoft System sh.p.k NIPT J61820021C me oferte ekonomike 37.211.605 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë gjashtëqind e pesë) leke pa TVSH.
3. Operatori Operatori “Sinteza CO” Shpk NIPT K11324003F me oferte ekonomike 41.899.000 (dyzet e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) leke pa TVSH
4. Bashkimi i operatoreve ekonomik BNT Electronics sh.p.k me NIPT J61817047D dhe S&T shpk me NIPT K52207006Q me oferte ekonomike 41.890.980 (dyzet e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) leke pa tvsh.
5. Operatori ekonomik PC.Store sh.p.k i cili nuk ka paraqitur oferte dhe dokumentacion.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik C.C.S sh.p.k me NIPT J61901033C me oferte ekonomike 34.854.700 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind) leke pa TVSH.
2. Operatori Infosoft System sh.p.k NIPT J61820021C me oferte ekonomike 37.211.605 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë gjashtëqind e pesë) leke pa TVSH.
3. Bashkimi i operatoreve ekonomik BNT Electronics sh.p.k me NIPT J61817047D dhe S&T shpk me NIPT K52207006Q me oferte ekonomike 41.890.980 (dyzet e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) leke pa tvsh.
4. Operatori ekonomik PC.Store sh.p.k i cili nuk ka paraqitur oferte dhe dokumentacion.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **Operatori ekonomik C.C.S sh.p.k me NIPT J61901033C**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezultoi që nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht:

C.C.S shpk nuk plotëson kërkesat e kualifikimit në përputhje me nenin 46 dhe 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar pasi: Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik” është kërkuar disponimi i certifikatave ISO konkretisht :

Shtojca 9 pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4: Operatori Ekonomik duhet të paraqese Certificate ISO 22301:2012 mbi “sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” ose ekuivalente me të (Certificate duhet të jete e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike KVO konstaton se certificate ISO 22301:2012 mbi “sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” për operatorin ekonomik “CCS” shpk është lëshuar nga EuroCert Greqi. Në përmbushje të kriterëve të kualifikimit si edhe nenit 46 pika 2 dhe nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certificate të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”

Nga verifikimet e kryera KVO konstaton se shoqëria EUROCERT A.E.- European Inspection and Certification Company SA (EUROCERT A.E.) është e akredituar nga ESYP () e cila është trupa akredituese në Republikën e Greqisë, ekuivalente me DPA në Republikën e Shqipërisë. Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare <http://www.esyd.gr/portal/p/esyd/en/showOrgInfo.jsp?id=17589> rezulton se EUROCERT A.E.- European Inspection and Certification Company SA (EUROCERT A.E.) nuk është e akredituar në cilësinë e trupës certifikuese për lëshimin e certifikatës ISO 22301:2012 mbi “sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” Sa më sipër certificate të mësipërme nuk është lëshuar nga një ent i akredituar.

2. Nuk përmbush kriteret e shtojcës 9 Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/Pranimi pika 1, shkronja d e DST, konkretisht :

Referuar vërtetimit nr. T 00311294 date 22.05.2018 lëshuar në formë elektronike nga sistemi C@TS konstatohet se subjekti ka detyrime tatimore të pa shlyera duke rënë ndesh me, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit .

3. Nuk përmbush kriteret e shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik”, pika 2.3.7 e DST : ”Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuësi(distributori duhet të vërtetojë se është autorizuar nga prodhuësi)”.

Operatori ekonomik CCS shpk ka dorëzuar Autorizimin lëshuar nga distributori i kompanisë CISCO, ITD shpk, shoqëruar me një marrëdhëveshje distribucioni nënshkruar nga Cisco dhe ITD shpk. Marrëveshja e mësipërme nuk është e plotë dhe në të nuk pasqyrohen tagrat e distributorit të autorizuar në rast se është rishitës dhe ka të drejtë të rishesë pajisjet cisco tek palë të treta si edhe hapësirën gjeografike. Dokumentacioni i mësipërm nuk pasqyron lidhjen prodhuësi-distributori i autorizuar i prodhuësit, pasi të gjithë anekset e kontratës nuk janë dorëzuar.

4. Nuk përmbush kriteret e shtojcës 10 Specifikimet Teknike, pika 1, Printer Termik konkretisht : Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur sipas Urdhrit të Prokurimit nr.21/1.prot date 27.04.2018, të Autoritetit Kontraktor, bazuar në nenin 46, 53 të ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për

prokurimin Publik” i ndryshuar, ne nenin 66 e vijues te Vendimit nr.914 date 29.12.2014, te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar, me procesverbalin nr.1 te dates 29.05.2018, i eshte drejtuar ne rruge elektronike prodhuesve per datasheet te produkteve te deklaruar nga ana e operatoreve ekonomike.

Ne pergjigje te kerkeses tone, ne rruge elektronike, nga ana e prodhuesve te produkteve objekt i procesit te prokurimit, na eshte vene ne dispozicion materiali i kerkuar, nga i cili rezulton se:

Në lidhje me printerin termik TYSSO modeli: AP-PRP-300-BI-BG-U-2-TYS nga verifikimi i Autorizimit të Prodhuesit dhe Deklaratës së Prodhuesit Fametech (TYSSO) rezulton se: Nga verifikimet e kryera në përputhje me nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të komunikimit elektronik me prodhuesin Fametech TYSSO , konstatohet dhe provohet nga prodhuesi se printeri sipas modelit te deklaruar nga Operatori Ekonomik ka specifikime te ndryshme me printerin model te prodhuar nga prodhuesi dhe konkretisht :

- Ne datasheet zyrtar cilesia Print life=100 km, nderkohe ne specifikime teknike eshte deklaruar Print life \geq 150 km
 - Ne datasheet zyrtar cilesia Auto Cutter = partial, ne datasheet te dorezuar nga OE eshte shenuar Auto Cutter \geq 1.5 Billion cuts
 - Ne datasheet zyrtar cilesia Paper width = 79.5mm \pm 0.5mm, nderkohe ne datasheet te dorezuar Media Width = 80 mm, 58 mm
 - Gjithashtu eshte shtuar edhe cilesia Memory = 64 Mb, e cila nuk eshte e cilesuar ne datasheet zyrtar.
5. Nuk perbush kriteret e shtojces 10 Specifikimet Teknike, pika 2 Referuar specifikimeve teknike te paisjes kompjuter desktop, sipas DST dhe specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor, ne lidhje me parametrin ”Slots” eshte Minimumi (4) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E x16. Nderkohe referuar datasheet te dorezuar rezulton se desktop i OE “C CS” shpk nuk permbush minimumin 4 PCI/PCIE, pasi disponon 3 nga 4 te kerkuar. Ne dokumentin e specifikimeve teknike eshte shenuar qe nderfaqet M.2 SSD dhe M.D WIFI jane nderfaqe PCIe, nderfaqet M.2 dhe PCIe ndryshojne nga menyra si lidhen paisjet ne motherboard dhe madhesia e tyre.
6. Referuar deklarates se prodhuesit rezulton se nuk jane pasqyruar permbushja ne minimum te specifikimeve teknike per kompjutera Desktop duke mos dhene asnje te dhene mbi paramtrat si: Lockable port cover, Chasis lock support.
- Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, rezulton që oferta e operatorit ekonomik C.C.S sh.p.k nuk kualifikohet.

2. Operatori Infosoft System sh.p.k NIPT J61820021C

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht:

- a) Nuk perbush kriteret e shtojces 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik”, pika 2.3.9 të dokumenteve të procedurës së prokurimit, konkretisht:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për mallin që ofron, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjitha termat dhe kushtet e garancisë teknike që ai mbulon, si dhe periudha e garancisë teknike si me poshte vijon:

Pika 5. Fotokopje Multifunction Stand Alone B & W Copy Machine A3 1 vit ose 120.000 kopje nga momenti i marrjes ne dorezim, kush te arrihet me pare; OE "Infosoft System" shpk ka dorëzuar në SPE, Deklaratën mbi garancinë, ku për fotokopjen multifunkionale A3 Xerox B8045 ka deklaruar si garanci 2 vite ose 30,000 kopje kush të arrihet më para. Sa më sipër, OE ka deklaruar një garanci më të vogël se minimumi i kërkuar nga autoriteti kontraktor ku është kërkuar 120,000 kopje ndërkohë që është ofertuar dhe deklaruar garanci për 30,000 kopje duke mos plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave i ngritur sipas Urdhrit te Prokurimit nr.21/1.prot date 27.04.2018, te Autoritetit Kontraktor, bazuar ne nenin 46, 53 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar, ne nenin 66 e vijues te Vendimit nr.914 date 29.12.2014, te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, me procesverbalin nr.1 te dates 29.05.2018, i eshte drejtuar ne rruge elektronike prodhuesve per datasheet te produkteve te deklaruar nga ana e operatoreve ekonomike.

Ne pergjigje te kerkeses tone, ne rruge elektronike, nga ana e prodhuesve te produkteve objekt i procesit te prokurimit, na eshte vene ne dispozicion materiali i kerkuar, nga i cili rezulton se :

- a) Per produktin IP VOIP PHONE ka mosperputhje e deklaraten e dorezuar mbi periudhen e garancise, pasi deklarohet se prodhuesi CISCO ofron garanci 1 vit per produktin e kerkuar nga 2 te kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor ne dokumentet e procedures se prokurimit..
- b) Në lidhje me printerin termik TYSO modeli: AP-PRP-300-BI-BG-U-2-TYS nga verifikimi i Autorizimit të Prodhuesit dhe Deklaratës së Prodhuesit Fametech (TYSO) rezulton se: Nga verifikimet e kryera në përputhje me nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me anë të komunikimit elektronik me prodhuesin Fametech TYSOO , konstatohet dhe provohet nga prodhuesi se printeri sipas modelit te deklaruar ka specifikime te ndryshme me printerin me modelin e prodhuar nga prodhuesi dhe konkretisht :
 - Ne datasheet zyrtar cilesia Print life=100 km, nderkohe ne specifikime teknike eshte deklaruar Print life \geq 150 km
 - Ne datasheet zyrtar cilesia Auto Cutter = partial, ne datasheet te dorezuar nga OE eshte shenuar Auto Cutter \geq 1.5 Billion cuts
 - Ne datasheet zyrtar cilesia Paper width = 79.5mm \pm 0.5mm, nderkohe ne datasheet te dorezuar Media Width = 80 mm, 58 mm
 - Gjithashtu eshte shtuar edhe cilesia Memory = 64 Mb, e cila nuk eshte e cilesuar ne datasheet zyrtar

b) Nuk permbush kriteret siapas shtojcës 9 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" kapaciteti teknik dhe konkretisht pika 2.3.7:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese per mallin objekt prokurimi **ose** nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi(distributori duhet te vertetoje se eshte autorizuar nga prodhuesi).

Në lidhje me produktet e prodhuesit CISCO operatori ekonomik Infosoft System shpk ka dorëzuar Autorizimin lëshuar nga distributori i Kompanise CISCO, ITD shpk shoqëruar me një marrëveshje distribucioni nënshkruar nga Cisco dhe ITD shpk. Marrëveshja e mësipërme nuk është e plotë dhe në të nuk pasqyrohet fakti se shoqëria ITD shpk shfaqet në cilësinë e distributorit të autorizuar për Republikën e Shqipërisë e prodhuesit Cisco, tagrat e distributorit të autorizuar në rast se është rishitës dhe ka të drejtë të rishesë paisjet Cisco tek palë të treta. Dokumentacioni i mësipërm nuk

pasqyron lidhjen prodhues-distributor i autorizuar i prodhuesit, pasi të gjithë ankeset e kontratës nuk janë dorëzuar.

c) Nuk permbush kriteret e shtojces 10 Specifikimet Teknike, pika 2 specifikimeve teknike te paisjes kompjuter desktop, ne dokumentet e procedures se prokurimit specifikimet teknike, ne lidhje me parametrin "Slots" nga ana e autoritetit kontraktor eshte kerkuar Minimum (4) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E x16. Nderkohe referuar katalogut te dorezuar rezulton se desktop i OE "Info Soft System" shpk nuk permbush minimumin 4 PCI/PCIE, pasi disponon 3 nga 4 te kerkuar.

d) Referuar deklarates se prodhuesit rezulton se nuk jane pasqyruar permbushja ne minimum te specifikimeve teknike per kompjutera Desktop duke mos dhene asnje te dhene mbi paramtrat si: Lockable port cover, Chasis lot support.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", te ndryshuar, ku parashikohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit", rezulton që oferta e operatorit ekonomik Infosoft System sh.p.k nuk kualifikohet.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomik BNT Electronics sh.p.k me NIPT J61817047D dhe S&T shpk me NIPT K52207006Q

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë "BNT Electronics" shpk & "S&T Albania" shpk nuk shpk nuk plotëson kërkesat e kualifikimit në përputhje me nenin 46 dhe 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar pasi:

a) Nuk permbush kriteret sipas shtojcës 9 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" kapaciteti teknik 2.3.8 konkretisht :

"Operatori ekonomik duhet te kete minimumi 8 (tetë) punonjes te punesuar per periudhen tetor 2017-mars 2018, nga te cilet: 2 (dy) teknik per implementimin e software te menaxhimit te printimit. 4 (kater) teknik te certifikuar per paisjet multifunksionale. 2 (dy) Specialiste te certifikuar nga prodhuesi per serine e kompjuterave te ofruar".

Në përmbushje të kriterit të mësipërme BOE ka dorëzuar kontratën e bashkëpunimit nr. 1219, repertori nr.141/1 koleksioni datë 22.05.2018 ku konstatohet se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "S&T Albania" shpk ka marrë përsipër furnizimin me paisje desktop.

Në baze te nenit 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar ku parashikohet se : *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".*

Anëtari i BOE "S&T Albania" shpk duhet të disponojë dy ekspertë të certifikuar nga prodhuesi për serinë e kompjuterave. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se anëtari S&T shpk ka dorëzuar dy transkripte ne cilesine e certifikatave të punonjësve M.Xhaferri dhe I.Arap. Për dy inxhinierët e mësipërm nuk janë dorëzuar certifikata dhe dokumentacioni i mësipërm nuk është i barazvlefshëm me certifikatën, pasi nuk specifikon fushën e njohurive, vlefshmërinë e saj, datën e lëshimit, gjenaralitetet të plota të inxhinierit, nënshkrim elektronik ose vulë e trupës trajnuese (DELL).

b) Nuk përmbush kriteret sipas shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” kapaciteti teknik” konkretisht:

- Pika 2.3.2 e DST, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikate ISO OHSAS 18001-2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente me të.
- Pika 2.3.7 e DST, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikate Certifikate ISO 22301:2012 mbi “sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” ose ekuivalente me të.

Nga verifikimet e kryera Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “BNT Electronics” shpk & “S&T Albania” shpk nuk është vërtetuar disponimi i certifikatave ISO OHSAS 18001-2007 dhe ISO ISO 22301:2012 megjithëse ky anëtar I BOE disponon 43 % të kapacitetit teknik dhe referuar natyrë dhe elementëve konkretë të bashkëpunimit të marrë përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit shfaqet e nevojshme disponueshmëria e dy certifikatave të mësipërme ISO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur sipas Urdhrit të Prokurimit nr.21/1.prot date 27.04.2018, të Autoritetit Kontraktor, bazuar në nenin 46, 53 të ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 66 e vijues të Vendimit nr.914 date 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me procesverbalin nr.1 të dates 29.05.2018, i është drejtuar në rrugë elektronike prodhuesve për datashet të produkteve të deklaruara nga ana e operatoreve ekonomike.

Në përgjigje të kërkesës tone, në rrugë elektronike, nga ana e prodhuesve të produkteve objekt i procesit të prokurimit, na është venë në dispozicion materiali i kërkuar, nga i cili rezulton se :

7. Nga verifikimet e kryera në përputhje me nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të komunikimit elektronik me prodhuesin Bixelon LLC, konstatohet se MAF i dorëzuar në procedurën e prokurimit nuk është lëshuar ndonjëherë nga BIXOLON për Sher Electronics , ndaj Sher Electronics nuk është distributor i autorizuar dhe rishitës për territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për projektin në fjalë i prodhuesit të paisjeve Bixelon, sipas komunikimit elektronik të datës 30.05.2018.
8. Referuar katalogut të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për modelin e Scanner A4, krahasuar me specifikimet teknike minimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor rezulton se skaneri i dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike pasi nuk disponon *teknologjinë Dual CIS, por vetëm CIS duke rëndë ndesh me DST.*
9. Referuar katalogut të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për modelin e printerit ML 5721, krahasuar me specifikimet teknike minimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor rezulton se printer i dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike pasi nuk disponon *cilësinë roll paper (pra ky printer nuk mund të perdoret me leter rul)*
10. Referuar katalogut të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike Software i ofruar për menaxhimin e printimeve Kyocera Net Admin & Fleet Services nuk realizon kërkesat: Follow me print dhe shared queues. Sa me sipër, dokumentacioni i dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, rezulton që oferta e bashkimit të operatoreve ekonomike B.N.T sh.p.k & S&T Albania sh.p.k nuk kualifikohet.

4. Operatori ekonomik PC.Store sh.p.k i cili nuk ka paraqitur oferte dhe dokumentacion.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik te ofertes se ofertuar ne kete procedure prokurimi rezulton se nuk ka paraqitur oferte dhe dokumentacion. Operatori ekonomik nuk i përmbushen kriteret tekniko ligjore për kualifikim.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*”, rezulton që oferta e operatorit ekonomik PC.Store sh.p.k. nuk kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Sinteza CO” Shpk NIPT K11324003F se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 41.899.000 (dyzet e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH, pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr.“Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.06.2018.

Ankesa:PO;

Në datë 11.06.2018 është paraqitur ankesa nga operatori “C.C.S” (Computer & Copier System) sh.p.k me Nr.1983 Prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 1983/1 prot, datë 18.06.2018.

Në datë 13.06.2018 është paraqitur ankesa nga operatori “Infosoft Systems” sh.p.k me Nr.1999 Prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 1999/1 prot, datë 18.06.2018.

Brenda afateve ligjore që nga trajtimi i ankesave nuk ka patur ankesa pranë KPP.